

Kalendari i vitit shkollor 2026–2027

Ky është kalendari për vitin shkollor 2026–27 për shkollat NYCPS nga programi 3-K deri në klasën e 12-të. Nëse fëmija juaj ndjek një shkollë private, fetare (parokiale), shkollë charter, Qendër të Edukimit të Hershëm të Nju Jorkut (NYC Early Education Center - NYCEEC), ose Program Kujdesi Familjar për Fëmijë (Family Childcare Program), ju lutemi kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj për informacion mbi kalendarin e tyre. Ju lutemi vini re sa më poshtë:

- Në ditët kur ndërtesat e shkollave janë të mbyllura për shkak të motit të keq ose emergjencave të tjera, NYCPS mund të zhvillojë mësim në distancë.
- Datat e konferencave prind-mësues të shkollave individuale mund të jenë të ndryshme nga datat e mëposhtme. Mësuesi i fëmijës tuaj do të kontaktojë me ju për të caktuar orarin e konferencës.
- Në këtë orar, **shkollat fillore** përkufizohen si programe që ofrojnë mësim nga kopshti (K) deri në klasën e 8-të, duke përfshirë edhe shkollat me programe 3-K dhe Parashkollor (Pre-K), si dhe ato që përfundojnë në klasën e 5-të ose të 6-të. **Shkollat e mesme** përkufizohen si programe që ofrojnë mësim nga klasa e 6-të deri në të 8-ën, dhe **shkollat e mesme të larta** si programe që ofrojnë mësim nga klasa e 9-të deri në të 12-tën. **Shkollat 6-12** përkufizohen si programe që ofrojnë mësim vetëm nga klasa e 6-të deri në të 12-tën brenda një shkolle të vetme.

Data	Dita e Javës	Ngjarja
10 shtator	E enjte	Dita e parë e shkollës
21 shtator	E hënë	Yom Kippur, shkollat të mbyllura
23 shtator	E mërkurë	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme dhe shkollat D75
24 shtator	E enjte	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12
30 shtator	E mërkurë	Takime të mbrëmjes midis prindërve dhe mësuesve për shkollat fillore dhe qendrat Pre-K.
12 tetor	E hënë	Dita e Trashëgimisë Italiane/Dita e Popujve Autoktonë, shkollat të mbyllura
3 nëntor	E martë	Dita e Zgjedhjeve, mësimi do të zhvillohet në distancë për të gjithë nxënësit
5 nëntor	E enjte	Konferencat prind-mësues në pasdite dhe mbrëmje për shkollat fillore dhe qendrat dhe qendrat Pre-K; nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
11 nëntor	E mërkurë	Dita e Veteranëve, shkollat të mbyllura
12 nëntor	E enjte	Konferencat Prind-Mësues në pasdite dhe mbrëmje për shkollat e mesme dhe D75; nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
19 nëntor	E enjte	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12
20 nëntor	E premte	Konferencat Prind-Mësues në pasdite për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12; nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
26–27 Nëntor	E enjte-e premte	Pushimi i Falënderimeve, shkollat të mbyllura
24 dhjetor-1 janar	E enjte-e premte	Pushimi dimëror, shkollat të mbyllura

18 janar	E hënë	Dita e Rev. Dr. Martin Luther King Jr., shkollat të mbyllura
26-29 Janar	E martë–E premte	Zhvillimi i provimeve Regents
1 shkurt	E hënë	Dita e Zhvillimit Profesional; nxënësit që ndjekin shkollat e mesme të larta dhe shkollat që ofrojnë vetëm klasat 6–12 nuk marrin pjesë në shkollë. Të gjithë nxënësit e tjerë marrin pjesë në shkollë.
2 shkurt	E martë	Fillon Semestri i Pranverës
15-19 shkurt	E hënë–E premte	Pushimi i Mesdimrit, shkollat të mbyllura
3 mars	E mërkurë	Konferencat prind-mësues në pasdite dhe mbrëmje për shkollat fillore dhe qendrat parashkollore (Pre-K Centers); nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
4 mars	E enjte	Konferencat Prind-Mësues në pasdite dhe mbrëmje për shkollat e mesme dhe shkollat D75; nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
9 mars	E martë	Eid al-Fitr (Fitër Bajrami), shkollat të mbyllura
18 mars	E enjte	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme të larta, K–12 dhe 6–12
19 mars	E premte	Konferencat prind-mësues në pasdite për shkollat e mesme të larta, K-12 dhe 6-12; nxënësit në këto shkolla mbarojnë tre orë më herët
26 mars	E premte	E premtja e mirë, shkollat të mbyllura
22-30 prill	E enjte-e premte	Pushimi i Pranverës (Spring Recess), shkollat të mbyllura
12 maj	E mërkurë	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme të larta, K–12 dhe 6–12
13 maj	E enjte	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat e mesme dhe shkollat D75
17 maj	E hënë	Eid al-Adha (Kurban Bajrami), shkollat të mbyllura
26 maj	E mërkurë	Mbrëmja e Konferencave Prind-Mësues për shkollat fillore dhe Qendrat Parashkollore (Pre-K Centers)
31 maj	E hënë	Dita e Kujtimit (Memorial Day), shkollat të mbyllura
8 qershor	E martë	Dita Zyrtare (Clerical Day); nuk ka mësim për nxënësit që ndjekin 3-K, Parashkollor (Pre-K), shkollat fillore, shkollat e mesme, shkollat K–12 dhe programet e veçanta D75
10 qershor	E enjte	Dita e Përvjetorit / Dita e Konferencës së Kancelarit për zhvillim profesional të stafit; nxënësit nuk marrin pjesë në shkollë
15- 18; 21 - 25 qershor	E martë-E premte; E hënë- E premte	Zhvillimi i provimeve Regents
28 qershor	E hënë	Dita e fundit e shkollës për nxënësit